

ANA LALAJ

NDARJE TË TRISHTUARA

Një vështrim historik - juridik mbi martesat midis shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Më 1990, rënë e pa rënë ende sistemi komunist në Shqipëri, në përpjekjet më të para për të lëvizur drejt botës, mësuam se disa nga individët e atëhershëm publikë kishin mundur të rivendosnin kontaktet e ndërprera për 30 vjet me ish-gratë dhe fëmijët e tyre, më të shumtët në vendet e Lindjes e sidomos në ish-Republikat Sovjetike. Historitë që kemi dëgjuar me këtë rast, nga më të ndryshmet, kanë të përbashkët ndjenjën e dhembjes dhe mallit të gjatë jo vetëm midis bashkëshortëve të hershëm, po sidomos midis baballarëve që u ndanë me fëmijët ende të vegjël dhe fëmijëve që fytyrën e të atit e kishin vetëm në fotografi. Sot, sigurisht, gjithkush prej nesh është në gjendje të vlerësojë traumat e këtyre familjeve, pasojë e divorceve të dhunshme; është në gjendje po ashtu ta kuadrojë gjithë sa ka ndodhur brenda një drame më të gjerë të luftës klasore, që përshiu familjen shqiptare në vitet e komunizmit. Por, edhe për shkak të hapësirës së trajtimit, më duhet t'u shmangem historive të qëmtuara dhe vështrimeve emocionale, për ta parë të përbashkëtën e familjeve: shtetas shqiptarë dhe shtetas të huaj, si një proces dhe dukuri që gjithsesi ka një kohë dhe hapësirë të vetën, mbështetje dhe kufizime ligjore, por dhe mbivendosje të politikës, lëshime dhe shtrëngesa të kësaj të fundit, deri në ndërhyrjet më të skajshme. Shkurt, një proces i lexueshëm në kontekstet e kohës.

Kur flasim për familjen në gati 50 vitet e sistemit të kaluar në Shqipëri, kjo nuk mund të shihet e ndarë nga vetë ndërtimi e funksionimi i shoqërisë shqiptare në tërësi. Orientimi komunist që në krye të herës i shtetit dhe i kësaj shoqërie, në një farë mënyre kishte paracaktuar edhe orientimin e familjes. Një shoqëri e vënë nën kontroll nga partia-shtet do të thoshte se e tillë do të ishte, pra nën kontroll, edhe qeliza e saj, familja e deri individi. Ky është orientimi i përgjithshëm dhe në shërbim të tij janë ligjet, organizatat politike e shoqërore, gjithë sistemi i propagandës

etj. Këtij radikalizmi i nënshtrohej jeta private e individit, sipas tij formatoheshin marrëdhëniet në çift, jeta intime, lidhjet martesore, përkatësia klasore në këto lidhje, divorcet etj. Këto tashmë janë të njohura, ndonëse jo të studiuara ende në mënyrë shteruese. Pjesë e kësaj dukurie janë edhe marrëdhëniet e mundimshme në çift që u krijuan në periudhën që flasim midis nënshtetasve shqiptarë dhe nënshtetasve të huaj, kryesisht nga vendet e ish-Blokut Komunist. Kjo çështje mendoj se do parë edhe në kuadër të legjislacionit të kohës, por edhe në kuadër të orientimeve politike dhe të praktikave ekstraligjore të strukturave partiake e shtetërore. Kjo e dyta nuk është më pak e rëndësishme, pasi shfaqet me shumë peshë në shoqëritë totalitare komuniste.

Për sa i përket legjislacionit për martesat me të huajt, do thënë se ai përgjithësisht ishte i ndërtuar në përshtatje me ligjet e vendeve të tjera komuniste. Si hapësirat ashtu dhe kufizimet janë të krahasueshme nga një vend në tjetrin. Ndërsa praktikat zbatuese kanë variuar në varësi të politikave që ka ndërtuar secili nga shtetet veçmas. Në këtë pikëpamje, praktikat e ndjekura nga organet e shtetit shqiptar meritojnë studim. Për të krijuar inteligjencën e re mbështetëse, qeveria komuniste çoi mjaft djem dhe vajza shqiptare në BS dhe në vendet e tjera të “kampit” për studime universitare. Djemve shqiptarë, që në pjesën më të madhe vinin nga lufta apo nga fshati, u jepeshin porosi standarde në komitetet e partisë dhe në Ministrinë e Arsimit se detyra e tyre ishte “mësimi dhe vetëm mësimi, se ata duhet të përgatiten si kuadro të aftë që t’i shërbejnë sa më mirë popullit e partisë”¹. Por për rrethana të kuptueshme dhe krejt të natyrshme, u krijuan edhe marrëdhënie dashurie midis studentëve, mjaft prej të cilave ishin të qëndrueshme dhe shkonin drejt nevojës për lidhje martesore, duke u kthyer kështu në një preokupim për zgjidhje.

Fillimisht legjislacioni shqiptar e lejonte martesën e studentëve shqiptarë jashtë shtetit me shtetase të huaja duke marrë autorizim nga Ministria e Punëve të Jashtme e RP Shqipërisë (më tej MPJ) ose nga përfaqësuesi diplomatik shqiptar në shtetin në fjalë.² Në formë, ky ligj

¹ Këto deklarata i janë dhënë autores gjatë intervistave me ish-studentë shqiptarë që shkonin për studime jashtë shtetit, në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e demokracive popullore të Lindjes.

² *Ligji mbi Martesën Nr. 601, dt. 18.V.1948, neni 23*: “... Nëpunësit shqiptarë dhe studentët shqiptarë nuk mund të lidhin martesë jashtë shtetit me një shtetas të huaj pa autorizimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme ose të përfaqësuesit diplomatik shqiptar jashtë shtetit.”

nuk ndryshonte shumë nga ai i paraluftës.³ Por në realitet as ambasadat shqiptare dhe as MPJ nuk jepnin leje për lidhjen e martesës. Shqetësimi i tyre qëndronte në faktin se “studenti mund të lidhte martesë me një shtetase të huaj që nuk ka konditat e duhura dhe hyrja e saj në Shqipëri si bashkëshorte e studentit shqiptar do të jetë e padëshirueshme”⁴. Prandaj sapo mbërritën kërkesat e para në MPJ, kjo e fundit i kërkonte Ministrisë së Drejtësisë amendimin e ligjit të Martesës, pasi në atë ligj nuk caktoheshin sanksionet kundra atyre që martohen pa marrë autorizimin e MPJ. Por përgjigja e Ministrisë së Drejtësisë ishte e dyzuar. Nga një anë ajo pranonte se neni 39 i Ligjit nuk sanksiononte anulimin e martesës kur studentit nuk merrte autorizim nga MPJ⁵ dhe, nga ana tjetër, në kundërshtim me ligjin, sugjeronte se “ndaj zyrtarit shqiptar që kishte celebruar martesën dhe ndaj studentit ose nëpunësit mund të merreshin masa administrative... tue ia prerë bursën dhe, kundra bashkëshortit të huaj tue ia ndaluar hyrjen në Shqipëri... pasi rezulton person i padëshirueshëm”⁶.

Megjithatë kishte dhe raste të rralla kur lejoheshin martesat me vajza të huaja. Kjo ndodhte kur studentit apo oficerit shqiptar jashtë shtetit i bënte disa herë kërkesë KQ PPSH dhe ky i fundit pas verifikimeve nga Ministria e Brendshme dhe ambasada shqiptare në shtetin përkatës, i drejtohej organeve partiake të atij vendi, duke i parashtruar të gjitha rastet që ai i gjente të arsyeshme. Fillimisht këto hapa u ndërmorën për oficerët e rinj shqiptarë që kishin shkuar për studime ose kualifikime në Moskë. Vit pas viti, numri i tyre u shtua dhe në një listë që KQ PPSH ia paraqiste KQ PKBS në prill 1950, radhiteshin 24 syresh.⁷

³ *Kodi Civil*, “Gëzimi i të drejtave civile dhe shtetia”, Mbretëria Shqiptare, Ministria e Drejtësisë, Vlorë, Shtypshkronja Cav. G. Direttore & C., 1928, f. 1-17.

⁴ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), viti 1949, dos. 266. Shkresë e MPJ e dt. 22 shkurt 1949.

⁵ *Ligji mbi Martesën Nr. 601, dt. 18.V.1948, neni 39*: “Martesa mund të anulohet vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji”.

⁶ *AMPJ*, viti 1949, dos. 266. Shkresë e Ministrisë së Drejtësisë e dt. 3 mars 1949.

⁷ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Arkivi i Partisë (më tej: *AQPPSh*), viti 1950, dos. 30, Marrëdhëniet e PPSH me PKBS. Në letërën e KQ dërguar KQ PKBS midis të tjerash shkruhej: “Komiteti Qendror i PPSH duke marrë parasysh nga njëra anë dëshirën e madhe që ata kanë treguar në mënyrë të përsëritur për t’u martuar me qytetaret sovjetike dhe nga ana tjetër besnikërinë dhe dashurinë që ata kanë për Partinë e Punës së Shqipërisë dhe atdheun e tyre dhe për Partinë bolshevike, për Bashkimin Sovjetik e Stalinin e Madh, ia parashtron këtë çështje KQ PKBS me lutje që ta marrin në shqyrtim dhe t’i japë një zgjidhje të favorshme”.

Por duke përdorur në këto raste vetëm kanalet partiake, legjislacioni i kohës kishte dalë jashtë loje. Si për të sanksionuar këtë realitet, në vitin 1952 Presidiumi i Kuvendit Popullor miratoi një dekret që ndalonte martesën e një shqiptari me një nënshtetase të huaj dhe anasjelltas.⁸ Ky qëndrim kategorik ndikoi negativisht sidomos tek emigrantët shqiptarë para 29 nëntorit 1944, të cilët, të ndodhur përpara dilemës ose të mos martoheshin kurrë, ose të martoheshin vetëm me nënshtetase shqiptare, u detyruan të braktisnin nënshtetësinë e vet shqiptare. Mbeten për t'u vlerësuar arsyet e këtij kthimi prapa, së paku në pikëpamje formale të ligjit. Ndoshta se edhe vetë BS në legjislacionin e deriatëhershëm të tij e kishte të ndaluar martesën e qytetarëve sovjetikë me të huaj. Por siç del nga disa shpjegime të mëvonshme arsyetuese, duket se “në radhë të parë ishin arsye të sigurimit të shtetit... Njëpërmjet studentëve që martohen jashtë shtetit depërtojnë armiq në vendin tonë”.⁹ Është koha kur vepronte operacioni Rollback i Perëndimit për të përmbysur sistemin komunist në Shqipëri me anën e organizimit të emigracionit shqiptar jashtë, dhe kur “politika e goditjes”¹⁰ kundër “armiqve” të partisë dhe popullit brenda vendit ishte në kulmin e saj. Është interesante të vërehet se shkalla e rrezikut konsiderohej e ndryshme jo vetëm ndërmjet martesave që celebrroheshin në Perëndim dhe atyre në Lindje, por edhe për martesat brenda vetë vendeve të Lindjes. Kështu rreziku vlerësohej “minimal” për martesat me vajzat e Bashkimit Sovjetik, kurse me vajzat nga Hungaria, Çekosllovakia dhe Polonia, rreziku konsiderohej “real ... dhe duhej një kontroll rigoroz”¹¹. Sipas udhëheqjes komuniste shqiptare, në këto vende ku qeveritë sapo kishin braktisur format organizative të koalicionit, mbeturinat e sistemit të vjetër borgjez ende ishin të fuqishme dhe brezi i ri ende nuk ishte çliruar plotësisht prej tyre.

Megjithatë, përballë kërkesave të shumta të emigrantëve në Perëndim por ndoshta edhe nga frika e ndonjë akuze ndërkombëtare për dhunim të të drejtave të njeriut, autoritetet shqiptare u lëkundën dhe një vit më vonë, më 15 tetor 1953, një dekret i posaçëm e lejoi martesën

⁸ *Dekreti Nr. 1558, dt. 17 tetor 1952, neni 1*: “Asnjë qytetar shqiptar nuk mund të lidhë martesë me qytetarë të huaj qoftë në Shqipëri qoftë jashtë Shqipërisë”.

⁹ *AQPPSH*, viti 1954, dos. 16.

¹⁰ Në Platformën e Sigurimit të Shtetit të asaj kohe, “Politika e goditjes” kundër armikut të klasës zinte një vend të rëndësishëm. Njëkohësisht “Politika e goditjes” u shtri dhe në veprimtarinë e PPSH.

¹¹ *Ibid.*

vetëm për shqiptarët e kolonive, d.m.th. shqiptarët që kishin emigruar për punë në vendet e huaja.¹² Ky dekret nxiti studentët shqiptarë jashtë vendit të shtonin dhe ata trysninë e tyre. Në këto rrethana, Ministri i Drejtësisë Bilbil Klosi, do të sugjeronte një qëndrim ndryshe ndaj problemit në fjalë. Më 5 prill 1954, ai i shkruante KQ PPSH: “Avantazhet që do të kishim, po të lejonim martesën me leje të Presidiumit të Kuvendit Popullor janë:

a. - nuk do të bënim përjashtim nga vendet e kampit tonë në legjislacionin e martesës.

b. - do të na vinin edhe specialiste, se zakonisht studentët martohen me studente”.¹³

Madje ai kishte përgatitur edhe një projekt-dekret në të cilin i rekomandohej Presidiumit të Kuvendit Popullor të lejohehin martesat e nënshtetasve shqiptarë me të huaj, që ai të ishte më dorëlëshuar në lidhjen e martesave të nënshtetasve shqiptarë me nënshtetas sovjetikë, ndërsa me nënshtetas të demokracive popullore të lejohej martesa vetëm në raste të jashtëzakonshme. Me nënshtetas të vendeve kapitaliste martesa e nënshtetasve shqiptarë të jetë krejtësisht e ndaluar. Përpara se të vendosë për një martesë të këtij lloji, Presidiumit të Kuvendit Popullor i rekomandohej të marrë mendimin e organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.¹⁴ Me sa duket, në atmosferën e “shkrirjes së akujve” që kishte filluar në bllokun komunist pas vdekjes së Stalinit, era e ndryshimeve kishte arritur edhe në Shqipëri. Ky propozim u bë thelbi i Dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH, i shpallur një muaj më vonë, në 5 korrik 1954, për martesat me nënshtetasit e huaj.¹⁵ Shqipëria po ndiqte kështu shembullin e BS, i cili një vit më parë me një dekret të Presidiumit të Sovjetit Suprem kishte lejuar martesat e qytetarëve sovjetikë me nënshtetas të huaj. Në këtë mënyrë qeveria shqiptare shmangte edhe situatën e faktit të kryer, kur disa studentë

¹² *Dekreti Nr. 1746, dt. 15 tetor 1953, neni 1*: “Asnjë qytetar shqiptar nuk mund të lidhi martesë me qytetarë të huaj, qoftë në Shqipëri ose jashtë shtetit, me përjashtim të qytetarëve shqiptarë që kanë emigruar në punë në vende të huaja”.

¹³ *AQPPSH*, viti 1954, dos. 16.

¹⁴ *Ibid.*

¹⁵ *Dekreti Nr. 1897, dt. 5.7.1954, neni 1*: “Asnjë shtetas shqiptar nuk mund të lidhë martesë me shtetas të huaj, qoftë në Shqipëri ose jashtë shtetit, pa marrë më parë autorizimin e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore së Shqipërisë. Shtetasit shqiptarë që kanë emigruar me punë në vendet e huaja lejohen të lidhin martesë me shtetasit e huaj”.

shqiptarë, pa marrë miratim nga organet përkatëse në Shqipëri ishin martuar me vajzat ruse, që ishin të lira për këtë veprim nga shteti i tyre. Në vitin 1956, këtij dekreti do t'i bëheshin përsëri disa rregullime.¹⁶

Pavarësisht nga ndryshimet pozitive që po ndodhnin në legjislacionin shqiptar lidhur me martesat me nënshtetasit e huaj, partia-shtet në Shqipëri edhe në këtë fushë po reflektonte me vështirësi dhe plot dyshime. PPSH nuk e kishte pranuar plotësisht kthesën e Kongresit XX të PKBS për destalinizimin. Hapat që ajo kishte ndërmarrë ishin vetëm disa retushime të pjesshme dhe jothelbësore në vijën e saj të mëparshme politike. Po kështu, megjithëse amendimet në legjislacionin shqiptar lejonin celebrimin e martesës të oficerëve ose studentëve shqiptarë që dëshironin të martoheshin me vajza të huaja, atyre vazhdohej t'u bëhej presion i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga eprorët që të mos këmbëngulnin për t'i sjellë gratë e reja në Shqipëri. Ambasadat apo legatat shqiptare vazhdonin të mos u jepnin leje qytetarëve shqiptarë për t'u martuar me shtetas të huaj, në përputhje me udhëzimet e marra.¹⁷ Megjithëse këto martesë ishin ekskluzivisht me vajza nga vendet e bllokut komunist dhe këto vende i kishin hequr kufizimet për martesat me të huajt, fakt është se në Shqipëri, deri atëherë, vetëm KQ PPSH, ishte *de facto*, autoriteti që mund të lejonte martesat e kësaj natyre. Madje jo rrallë herë edhe vetë vajzat ruse, polake, hungareze etj., kur shihnin se problemi i martesës së tyre nuk po zgjidhej, i drejtoheshin drejtpërdrejt KQ PPSH. Kështu në një letër të një studenteje sovjetike dërguar Enver Hoxhës në vitin 1959, shkruhej: “Jam vajzë e popullit sovjetik. Kam rënë në dashuri dhe rroj me një toger shqiptar, se ai është djalë i mirë, se e dua atë me gjithë shpirt dhe se pa atë jeta ime nuk ka kuptim. Unë e di se ligji juaj nuk lejon martesat me të huajt, unë e di se ai është anëtar partie dhe se ajo do ta dërgojë nesër atje ku të jetë nevoja. Për sa i përket konditave tuaja, ato i kam marrë parasysh. Ju lutem, tregohuni pak humanitar....”¹⁸ Të brumosur me një psikologji sekreti, që impononte në çdo moment

¹⁶ *Dekreti Nr. 2228, dt. 5.3.1956, neni 1*: “Asnjë shtetas shqiptar nuk mund të lidhë martesë me një shtetas të huaj, qoftë në Shqipëri ose jashtë shtetit, pa marrë më parë autorizimin e MPJ kur të dy ose njeri prej personave që do të lidhin martesë banojnë jashtë shtetit dhe nga MPB kur të dy personat e sipërm banojnë në Shqipëri. Shtetasit shqiptarë që kanë emigruar me punë në vendet e huaja lejohen të lidhin martesë me shtetasit e huaj”.

¹⁷ *AQPPSH*, viti 1959, dos. 11.

¹⁸ *Ibid.*

kompleksin e frikës dhe të mbylljes, udhëheqësit shqiptarë druanin se mos fenomeni i martesave me vajzat e huaja përhapej në shkallë të gjerë. “Të gjithë ata që venë jashtë, po na martohen”¹⁹, shprehej në një mbledhje të Byrosë Politike Spiro Koleka. Megjithatë E. Hoxha duke pasur informacion më të gjerë se ç’po ndodhte në vendet e tjera të Bllokut Komunist, vendosi të lëshojë pe. Në të njëjtën mbledhje konkludonte se “jo vetëm që kemi ligje, por edhe parimisht nuk është e drejtë të mos lejojmë martesën me të huajt. Por këtë ne nuk duhet ta lëmë fare të lirë, por ta frenojmë”²⁰.

Sidoqoftë, në vitin 1959 pati një kthesë në procedurat praktike që miratonin martesat me nënshtetas të huaj. Në prill të atij viti, Byroja Politike e KQ PKSh me një vendim të posaçëm lejoi që “studentët dhe kursantët civilë e ushtarakë që ishin dërguar nga partia e qeveria për studime jashtë shtetit të ndiqnin procedurat standarde ligjore vetëm nëpërmjet MPJ të RP Shqipërisë dhe ambasadës shqiptare në shtetin ku ata studionin”. Ndër kushtet që duhej të plotësonin studentët shqiptarë, para se të martoheshin me vajza të huaja, më i rëndësishmi dhe i patolerueshmi ishte kriteri politik. Vendimi i Byrosë Politike theksonte se “nuk do të lejoheshin martesat me vajza që mbajnë qëndrim të keq politik ose rrjedhin nga familje reaksionare”²¹. Pas kësaj, kërkesat e studentëve shqiptarë vërshuan dhe 213 prej tyre arritën të martohen me vajza nga BS, Polonia, Hungaria, Bullgaria, Çekosllovakia, Rumania dhe t’i tërheqin ato në Shqipëri. Por në vitin 1961 kësaj pranvere të shkurtër i erdhi fundi dhe 65 studentëve të tjerë shqiptarë nuk iu miratua kërkesa për martesë.²²

Acarimi i marrëdhënieve ideologjike e politike ndërmjet PKSh dhe PKBS çoi në dimrin e madh të ndërprerjes së marrëdhënieve ekonomike, kulturore, ushtarake dhe diplomatike shqiptare-sovjetike. Udhëheqja shqiptare nuk pranoi të reviziononte politikën e saj staliniste dhe u vu përballë gjithë bllokut tashmë të institucionalizuar komunist. Kjo gjendje alarmi dhe lufte e shpallur nga partia-shtet iu imponua gjithë strukturave të shoqërisë shqiptare, madje dhe qelizës së saj, familjes. Në këtë situatë, ato që u ndjenë më të sfiduara ishin familjet e ish studentëve shqiptarë, të

¹⁹ *Ibid.*

²⁰ *Ibid.*

²¹ *Ibid.* Vendim i Byrosë Politike të KQ PPSH. Nr. 129, dt. 2.4.1959.

²² Ministria e Punëve të Brendshme (më tej: MPB), Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, D. 172.

martuar me gra të huaja. Ata kishin ngjitur shkallët e karrierës profesionale dhe politike, dhe ishin bërë personalitete në fushat ku punonin. Politika ndërhyri dhunshëm në jetën e tyre private. Në një mbledhje të Byrosë Politike të PPSH, kur sapo ishte marrë njoftimi i ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet BRSS dhe RP të Shqipërisë, E. Hoxha urdhëronte: “Është edhe çështja e grave sovjetike që janë martuar me njerëzit tanë. Shqiptarëve të cilët kanë marrë gra sovjetike u duhet thënë që ato do të venë në BS, sepse këtu po zhvillojnë punë armiqësore në dëm të atdheut dhe se do të vihen në survejim, ose të marrin nënshpëtim në shqiptare. Kur të rregullohen marrëdhëniet tona me BS, atëherë mund të shikohet edhe çështja e tyre.”²³ Paskëtaj ndaj grave sovjetike, e më vonë atyre polake, hungareze, çekosllloake, rumune, gjermanolindore, bashkëshortëve të tyre shqiptarë dhe gjithë familjeve të tyre filluan përndjekjet, provokimet, akuzat, shantazhet deri te kalvari i dhimbshëm i ndarjes. Të ngritura mbi ndjenjën e një dashurie të pastër, një pjesë e tyre i rezistuan furtunës politike, ndërsa shumica u shpërbë, duke lënë pas lot dhe kujtime. Sipas një raporti të Ministrisë së Punëve të Brendshme, deri në nëntor 1963 ishin larguar në shtetin e tyre përgjithmonë 66 gra të huaja. Nuk mund të përjashtohet që në shkatërrimin e këtyre familjeve kishin ndikuar edhe motive të tjera si qëndrimi moral, mospërshtatja me kushtet e vështira të jetesës në Shqipëri, ndryshimi i kulturave, ambicia e ndonjë bashkëshorti shqiptar me pozitë në parti e në pushtet për të bërë karrierë, por gjithnjë faktori determinues mbetej ai politik.

Është e vërtetë se edhe për disa muaj pas ndarjes, ndërmjet bashkëshortëve u mbajt një korrespondencë me letra ose me telefona, korrespondencë e cila ishte gjithnjë e survejuar dhe e keqinterpretuar nga organet e Sigurimit. Çdo ndjenjë njerëzore përthyej nën optikën politike si “qëndrim direkt ose indirekt kundër PPSH”. Kështu në një raport të Sigurimit të Shtetit shkruhet: “Nga bisedat telefonike të regjistruara dhe letrat e kapura del se burrat që ndodhen këtu u thonë grave të ikura të kenë durim dhe të mos mërziten, se së shpejti do të shihen etj., por nuk

²³ *AQPPSH*, viti 1961, dos. 47. Në Shqipëri lejohej vetëm një shtetësi për qytetarët shqiptarë apo për ata që vinin nga jashtë shtetit. Marrja e shtetësisë shqiptare nga shtetasit e huaj, do të thoshte që këta të fundit do t'i nënshtroheshin legjisllacionit shqiptar si gjithë shtetasit me kombësi shqiptare e me shtetësi shqiptare në RPSH. Marrja e shtetësisë shqiptare e lehtësonte veprimtarinë e organeve të rendit në Shqipëri për të ndjekur dhe persektuar ish shtetasit e huaj, politikisht të ndryshëm nga RPSH.

shpjegojnë se si do të shihen.... Kështu Y.A. i shkruan gruas së tij: “Kij kujdes veten dhe djalin... Jeni qeniet më të shtrenjta në botë dhe kështu do të jeni përgjithnjë... Thuaj djalit me rastin e 15 tetorit - tre vjetorit të tij, se babai atë e mendon gjithnjë, se unë jam me ju me shpirt dhe me zemër...Ty të uroj takim të shpejtë...”²⁴ etj. Skizofrenia politike shkoi deri atje sa edhe një bisedë telefonike ndërmjet prindit shqiptar dhe fëmijës së tij të larguar me t’ëmën në atdheun e kësaj të fundit konsiderohej si “provokim”. Kështu Sigurimi i shtetit i raportonte KQ PPSH: “Gratë që kanë ikur nga vendi ynë, 45 prej tyre kanë marrë nga një ose dy fëmijë me vete. Këto bëjnë presion të madh moral tek ish burrat e tyre, duke u nxjerrë fëmijët në telefon të bisedojnë, duke u dërguar fotografi të këtyre fëmijëve etj., me qëllim që burrat e tyre të gjejnë rrugëdalje për t’i marrë përsëri këto gra ose dhe për t’u arratisur.”²⁵ Por edhe bisedat telefonike edhe korrespondenca me letra erdhi duke u rralluar, derisa u ndalua tërësisht nga organet e Sigurimit. Kjo do të thoshte se letrat nuk u dorëzoheshin personave të adresuar dhe bisedat telefonike me jashtë nuk lejoheshin për këta persona. Atëherë, gratë sovjetike i postonin letrat nga Anglia, Kina, Bullgaria e shtete të tjera nëpërmjet turistëve, sportistëve, vizitorëve etj., që vinin në vendin tonë. Sipas mundësive këto kanale, megjithëse shumë më të kufizuara, i shfrytëzonin edhe shqiptarët.

Në një rast N.S. i shkruante gruas së tij në BS: “...Meqenëse disa njerëz po ikin për Paris dua të shfrytëzoj këtë rast... Në të gjitha vendet ka edhe njerëz të mirë, të cilët na kuptojnë ne dhe, sipas rastit të tyre, na ndihmojnë... Unë jam i kënaqur kur ti më beson se si jemi ne këtu, kështu që 50 për qind është problemi i ndalimit të korrespondencës... Neve duhet të përgatisim jetën tonë të përbashkët, kështu të bukur, ti atje dhe unë këtu, që kur të takohemi të jemi të shëndoshë...”²⁶. Por ky informacion reciprok i rrallë, i gjetur si rrugë për të ushqyer dhe për të mbajtur gjallë dashurinë bashkëshortore, si dhe shpresa për t’u bashkuar sërish, dilnin jashtë formatit të “njeriut të ri” dhe ishte jo vetëm i papranueshëm, por dhe i dënueshëm nga partia-shtet. Konkluzioni që nxirrnin organet e Sigurimit për këtë letërkëmbim njerëzor ishte se: “Përpjekjet për të mbajtur lidhje me çdo kusht të lenë dyshime për spiunazh dhe tregojnë se këta qëndrojnë në pozita armiqësore karshi vijës së partisë sonë”.²⁷ Mbi

²⁴ MPB, Drejtorja e Sigurimit të Shtetit, D. 172.

²⁵ Ibid.

²⁶ Ibid.

²⁷ Ibid.

këto hamendësime u ngrit një sistem i tërë përndjekjesh ndaj bashkëshortëve shqiptarë të mbetur në Shqipëri, duke i konsideruar ata “një bazë (të BS dhe vendeve të bllokut komunist-A.L.) për të dëmtuar interesat e partisë dhe popullit tonë”²⁸. Për rrjedhojë ata u vunë nën një regjim të rreptë përgjimi, kontrolloheshin se me kë i kalonin festat familjare, shoqërore dhe kolektive, çfarë bisedonin, sa herë shkonin në ambasadën e shtetit të huaj ku kishin studiuar etj. Konsiderohej negativ fakti që deri në vitin 1963, vetëm 7 prej tyre ishin rimartuar me vajza shqiptare, ndërsa arratisja e 5 prej tyre për t’u ribashkuar me gratë e larguara dhe fëmijët e tyre quhej “tradhti ndaj atdheut”.

Përndjekjet ishin akoma më të vrazhda ndaj grave të huaja që qëndruan në Shqipëri. Presionet ndaj bashkëshortëve të tyre për t’i ndarë ato ishin të vazhdueshme. Për të shpëtuar familjen, bashkëshortet e huaja hoqën dorë nga nënshtetësia e vet dhe morën nënshtetësinë shqiptare, si “shenjë besnikërie” ndaj partisë-shtet në Shqipëri. Kështu në muajt e parë të vitit 1962, Presidiumi i Kuvendit Popullor të RP të Shqipërisë me vendime të posaçme u dha nënshtetësinë shqiptare shumë grave sovjetike, bullgare e hungareze.²⁹ Vizitat në ambasadat dhe letërkëmbimi me familjarët në vendlindje konsiderohej herezi dhe me kalimin e viteve këto lidhje u ndërpre. Një pjesë e këtyre grave vazhdoi të punojë në institucionet shqiptare duke iu nënshtuar regjimit komunist në vend. Disa të tjera megjithëse kishin mbaruar shkollat e larta u kthyen në shtëpiake, për të reduktuar kontaktet me njerëzit e për rrjedhojë dhe mundësinë e akuzave kundër tyre për spiunazh. Ndërsa pati dhe nga ato që vazhduan të jetojnë në Shqipëri edhe kur burrat e tyre u burgosën për “spiunazh” apo u internuan.³⁰

Ky makth 30 vjeçar përfundoi vetëm pas ndryshimeve demokratike në fillim të viteve ’90, atëherë kur burrat dhe baballarët e zbardhur trokitën në portat e familjeve të reja të ish bashkëshorteve të dikurshme dhe fëmijëve të tyre. Por asgjë nuk mund të kthehej pas, përveçse kujtimeve.

²⁸ Ibid.

²⁹ Shih: *Gazeta Zyrtare të RP Shqipërisë*, viti 1962, Nr. 1, 2, 3, 4.

³⁰ Ndër gratë e huaja që kishin qëndruar në Shqipëri deri në vitin 1963, 8 ishin arsimtare, 12 nëpunëse, 14 inxhinierë, 2 zooteknike, 13 mjeke, 8 laborante, 1 farmacistë, 1 juriste, 3 rrobaqepëse, 4 artiste, 2 agronome, 1 hidraulike, dhe 58 shtëpiake. Ndër to kishin marrë nënshtetësinë shqiptare 32 gra.

S u m m a r y

TRISTFUL SEPARATIONS

A regard on the marriages between Albanian and foreign citizens

A society that was under the control of the Party-State, implicated the same control on its cellule as well; the family and the person. The struggling relationships of the couples that were created during this period between Albanian and foreign citizens, principally from countries of the ex-Communist Block, were part of this occurrence. This issue is observed within the legislation of that time, as well as within the political orientations and extra legal practices of the party and state structures.

In order to build the new supporting intelligence, the Communist government of Albania sent quite a few Albanian youngsters in the Universities of USSR and other countries of 'the camp' for studies. It was absolutely natural and understandable that love relationships would evolve between the students. Not few of them were proved stable and towards marital commitments, creating thus, a need for a solution. The Albanian legislation changed several times depending to the changes that underwent the Soviet legislation on marriages, which allowed marriages only between couples from communist countries. This was the situation until 1960. Later on, the aggravation of the ideological and political relations between the Communist Party of Albania and the Communist Party of USSR brought the interruption of the economic, cultural, military and diplomatic rapports between the two countries. This state of alert and war declared by the Party-State was imposed on all the structures of the Albanian society, even on its cellule, the family.

Under this situation, the families that went under the principal challenge were those of the ex-students married to foreign women and that now had become military, scientific, and cultural personalities. Politics intervened aggressively in their private life. Built on the feeling of pure love, part of these couples resisted against the political storm. However, most of them were separated, leaving behind tears and memories. According to a report of the Ministry of Home Affairs, until November 1963, 66 foreign women permanently returned to their countries. The fact that other motives might have influenced the separation of these families cannot be excluded. However, the determinant factor was the political one.

